Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian

MILIEUKONTAKT ALBANIA
SERVING SOCIETY TOWARDS SUSTAINABILITY

ETMI

# UDHËZUES




# PËR REDUKTIMIN E PLASTIKES NJËPËRDORISHME

**BOTUES** *© Milieukontakt Shqipëri*
**DATË** *Nëntor 2025*

**KONTAKT** ***Milieukontakt Shqipëri***
*Rr. "Xhorxhi Martini", Pall. Teuta Konstruksion,*
*Shk.3, Ap.8 Tiranë, Shqipëri*
*Tel. +355 42 256 528*
*office@milieukontakt.org*
*www.milieukontakt.org*

**DIZAJN & FAQOSJA**

mia architects
architecture and urban planning consulting office
miaarchitects22 @gmail.com cel:+355695442572

*"Ky publikim u prodhua nga Milieukontakt Shqipëri, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij janë përgjegjësi e vetme e Milieukontakt Shqipëri dhe Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.*

## *DY FJALË RRETH NISMËS PËRDOR MË PAK PLASTIKË*

*Jetojmë në një botë të komoditetit dhe të asaj që quhet "kulturë e të hedhurit". Pipat, qeset, shishet dhe përziersit plastikë janë pjesë e një game produktesh të krijuara për t'u përdorur vetëm një herë, ndonjëherë për disa sekonda, por që mbeten në planetin Tokë për dhjetëra vjet. Ato jo vetëm që janë të dëmshme për jetën e egër, por gjithashtu ndikojnë negativisht në shëndetin dhe ekonominë tonë.*

*Në Shqipëri, kjo plastike nuk menaxhohet. Ajo përfundon në landfill, në brigjet e lumenjve si Ishmi, Shkumbini, Buna e Vjosa, në liqene si ai i Shkodrës apo Pogradecit, dhe në detin Adriatik e Jon. Ajo dëmton jetën e egër, ndikon në shëndetin tonë dhe ul vlerën e turizmit, një nga shtyllat e ekonomisë shqiptare.*

*Po çfarë mund të bëjmë? Nëse jeni gati të reduktoni përdorimin e plastikës një përdorimshe (P1P) në biznesin tuaj, bëhuni pjesë e iniciativës "Përdor më pak Plastikë" (LPZ). Kjo iniciativë krijon një komunitet biznesesh që angazhohen për të reduktuar ndotjen plastike duke hequr gradualisht produktet P1P nga aktivitetet e tyre, në përputhje me Direktivën e Komisionit Evropian (2019/904).*

*Milieukontakt Shqipëri, ka kontribuar në zhvillimin dhe promovimin e nismës në Shqipëri dhe po e vijon atë në kuadër të projektit "RiverClean – Lumenj të pastër, Dete të pastër", të financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar në partneritet me Institutin për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit.*

*Ky material përdoret ekskluzivisht për ndërgjegjësim dhe trajnim të bizneseve të sektorit HoReCa (hotele, restorante dhe kafene), me synim reduktimin e plastikës njëpërdorimëshe, nxitjen e alternativave të qëndrueshme dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve. Përmbajtja bazohet në metodologjinë HAPI (Honest Alternatives to Plastic Index) zhvilluar nga Save the Med dhe praktikat e mira të nisura nga GIZ dhe MedWaves, me mbështetjen e BMZ si pjesë e programit "Integrated Waste Management and Marine Litter Prevention in the Western Balkans".*

*Edhe pse produktet P1P janë të lira dhe të përshtatshme, shumë pak mendojmë për ndikimin e tyre mjedisor: nga nxjerrja e lëndës së parë, përdorimi i energjisë dhe ujit për prodhim dhe transport, deri te kostoja e grumbullimit, trajtimit dhe riciklimit të mbetjeve.*

*HAPI është një sistem vlerësimi për produktet që merr parasysh legjislacionin lokal dhe infrastrukturën e menaxhimit të mbetjeve për të ndihmuar bizneset të marrin vendime të përgjegjshme. Indeksi (0-10) u mundëson të krahasojnë vlerësimet e produkteve plastike njëpërdorimëshe që ato përdorin aktualisht me një sërë alternativash, për të siguruar që zgjedhin alternativën që performon më mirë sipas një sërë kriteresh: ripërdorshmëria/qarkullueshmëria; lloji i materialit të përdorur; infrastruktura lokale për të ricikluar materialin; dhe gjasat që produkti të ndalohet nga legjislacioni.*

*Koha për të ndryshuar nga komoditeti plastik te zgjedhjet e zgjuara! Jo nesër, por SOT.*

# 85%

TË MBETURINAVE NË PLAZHET EVROPIANE PËRBËHEN NGA PLASTIKAT

*Gjysma është 'plastikë njëpërdorimshe' që përdoret vetëm një herë, për një kohë të shkurtër, përpara se të hidhet.*




# 13 MILIARDË EURO

në vit llogariten dëmet në nivel botëror në ekosistemet detare që shkaktohen nga plastika.

# 630 MILIONË EURO

në vit llogariten humbjet e shkaktuara nga plastika për turizmin Evropian dhe komunitetet bregdetare.

KËTO KATEGORI PËRBËJNË **43%** TË TOTALIT TË MBETJEVE DETARE.

10 PLASTIKAT NJË PËRDORIMSHE MË TË GJETURA JANË:
bishtat e cigareve, shishe dhe kapakë, shkopinj pambuku, qese patatinash, qese dhe peceta higjenike, takëme, pipa, përzjerës, gota pijesh, enë ushqimore, si dhe rrjeta peshkimi.




# 25.8 MILION TON

mbetje plastike gjenerohen cdo vit dhe më pak se 30% e tyre mblidhet apo riciklohet në Europë.

[1]*Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions: A European Strategy for Plastics in a Circular Economy. 16 January 2018. Available at: http://ec.europa.eu/environment/circular-economy/pdf/plastics-strategy.pdf*

## Po cilat janë produktet P1P që gjenden më shumë në plazhe?

**87%** e evropianëve janë të shqetësuar për ndikimin mjedisor të plastikës, dhe **74%** për ndikimin në shëndetin e tyre.

| ***Plastikë një përdorimshe (P1P)*** | ***Rreziku i hedhjes si mbeturinë*** | ***Ndërgjegjësimi i bizneseve turistike*** | ***Referenca*** |
|---|---|---|---|
| Shishet e ujit dhe shishet e tjera të pijeve, përfshirë kapakët | I lartë | I lartë | Një nga artikujt më të zakonshëm të gjetur në plazhe (WWF 2019; Ocean Conservancy 2019) dhe, ndër artikujt e rëndomtë (bishta cigaresh, ambalazhe), gjithashtu një nga më të rëndat. |
| produktet e higjienës një përdorimshe | I ulët | I lartë | Vëllim i lartë përdorimi në hotele. |
| Qeset plastike dhe qeset e mbeturinave | Mesatar/I ulët | Mesatar | Artikulli i gjashtë më i zakonshëm i gjetur në plazhet e Evropës. |
| Ambalazhi ushqimor | I lartë | I lartë | Pa mëdyshje një nga artikujt më të zakonshëm të gjetur në plazhe (WWF 2019; Ocean Conservancy 2019); 30–40% e gjithë furnizimit me plastikë përdoret për të prodhuar ambalazh ushqimor. |
| Gotat | I lartë/Mesatar | I lartë | Artikulli i tetë më i zakonshëm i gjetur në plazhet e Evropës. |




**94%**
mendojnë se produktet duhet të dizajnohen për të lehtësuar riciklimin.

**94%**
mendojnë se industria dhe tregtarët duhet të përpiqen të reduktojnë paketimin plastik.

**90%**
mendojnë se autoritetet lokale duhet të ofrojnë më shumë fonde dhe pajisje për mbledhjen e mbetjeve plastike.

**89%**
mendojnë se njerëzit duhet të edukohen mbi mënyrat për të reduktuar mbetjet e tyre plastike.

**61%**
mendojnë se konsumatorët duhet të paguajnë më shumë për mallrat plastike njëpërdorimëshe.

**Burimi: Eurobarometer**

## *Masa për të ndaluar P1P*

| | |
|---|---|
| *SHKOPINJ PAMBUKU* | *Ndalimi i shkopinjve të pambukut njëpërdorimësh të prodhuar me plastikë, për t'u zëvendësuar në treg me alternativa të qëndrueshme.* |
| *TAKËME, PJATA, PIPA DHE SHKOPINJ PËR PËRZIERJE* | *Ndalimi i takëmeve, pjatave, pipave dhe shkopinjve për përzierje njëpërdorimëshe të prodhuara me plastikë, për t'u zëvendësuar me alternativa më të qëndrueshme.* |
| *SHKOPINJ PËR TULLUMBACE DHE TULLUMBACE* | *Ndalimi i shkopinjve plastikë për tullumbace dhe zëvendësimi i tyre me alternativa të qëndrueshme. Për tullumbacet, prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen, trajtimin e mbetjeve dhe të vendosin etiketa të reja mbi ndikimin mjedisor të produktit dhe mundësitë e riciklimit për konsumatorët.* |
| *ENË USHQIMORE* | *Reduktim i ndjeshëm i konsumit kombëtar të enëve plastike për ushqim. Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve.* |
| *GOTAT PËR PIJE* | *Reduktim i ndjeshëm i konsumit kombëtar të gotave plastike për pije. Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve.* |
| *SHISHET E PIJEVE* | *Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve nga enët e pijeve; kërkesa për dizajnin e produktit për të vendosur kapakë dhe mbyllje në enët e pijeve; objektiv prej 90% për mbledhje të veçantë të shisheve plastike.* |
| *BISHTA CIGARESH* | *Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të bishtave të cigareve dhe filtrave të tjerë të produkteve të duhanit me plastikë.* |

| | |
|---|---|
| *QESE* | *Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e qeseve plastike të lehta, përveç masave ekzistuese në direktivën ekzistuese për qeset plastike.* |
| *PAKETA PATATINASH / AMBALAZHE ËMBËLSIRASH* | *Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e paketave dhe ambalazheve plastike.* |
| *SHAMI TË LAGURA DHE PRODUKTE SANITARE* | *Kërkesa të reja për etiketim për peceta sanitare dhe shami të lagura për të informuar konsumatorët mbi ndikimin mjedisor të produktit dhe mënyrën e hedhjes së tyre. Prodhuesit duhet të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit, pastrimin, mbledhjen dhe trajtimin e mbetjeve të shamive të lagura.* |
| *PAJISJE PESHKIMI* | *Prodhuesit e pajisjeve të peshkimit që përmbajnë plastikë do të detyrohen të mbulojnë kostot e mbledhjes së mbetjeve nga portet dhe transportin e tyre për trajtim. Ata gjithashtu do të mbulojnë kostot e masave për rritjen e ndërgjegjësimit.* |

## A. PIJET

**A.1** *Pipa plastik*
**A.2** *Përziersit plastik të kafesë*
**A.3** *Gota dhe filxhanë plastik*
**A.4** *Shishe plastike uji*
**A.5** *Shishe plastike lëngjesh*
**A.6** *Porcione individuale çaji*
**A.7** *Qese me porcione për kakao/çokollatë/salep*

## B. USHQIMET

**B.1** *Paketimet plastike për ushqimet*
**B.2** *Qeset plastike*
**B.3** *Paketimi për akulloret*
**B.4** *Lugë për akullore*
**B.5** *Pjata plastike*
**B.6** *Takëme plastike*
**B.7** *Shkopinj plasatik për antipasta*
**B.8** *Porcione individuale në mbështjellës plastik njëpërdorimësh (Vaj, uthull, mjaltë, krem çokollatë, gjalpë, drithëra, kos, ëmbëlsira, snacks etj.)*
**B.9** *Mbulese tavoline prej letre me një shtresë të hollë plastike*

## C. SIGURIA DHE HIGJENA

**C.1** *Produkte plastike tualeti*
**C.2** *Shishe plastike xhel dezinfektues*
**C.3** *Doreza plastike për një përdorim*
**C.4** *Shkopinj plastik me pambuk*
**C.5** *Furça dhëmbësh + pastë dhëmbësh njëpërdorimshe*
**C.6** *Kapuc dushi*
**C.7** *Fije dentare me kunja plastike*
**C.8** *Shapka njëpërdorimshe*

# PIJET PLASTIKA



HAPI
10

## PIPA PLASTIK



JO
PIPA
PLASTIKE

### *A KE MENDUAR NDONJËHERË TË PINI... PA PIPË?*

*Inkurajoni klientët tuaj që të mos përdorin pipa nëse nuk kanë një gjendje shëndetësore ose paaftësi që i bën pipat të domosdoshëm për ata.*

HAPI
0

## JO PIPA

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *0 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- falas*<br>*- mundësi për të edukuar klientët për P1P* |
| **DISAVANTAZHET** | *- duhet t'ju shpjegohen klientëve* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | |

## NË VEND TË TYRE, OFRO PIPAT E BUKURA, TË RIPËRDORSHME, EKOLOGJIKE DHE STIL!




*Pipat njëpërdorimëshe janë ndër ndotësit më të mëdhenj në plazhet tona dhe një rrezik serioz për jetën detare, sidomos për breshkat .*

| HAPI 3.24 METALIKE | HAPI 3.24 BAMBU |
| --- | --- |
| 30 - 155 LEK<br>(varet nga parametrat fizik) | 10-200 LEK<br>(varet nga parametrat fizik) |
| - I ripërdorshëm<br>- trend<br>- investim fillestar që shtrihet në kohë | - I ripërdorshëm<br>- origjinal<br>- pamje natyrore<br>- investim fillestar që shtrihet në kohë |
| - larje pas çdo përdorimi<br>- mund të humbasin<br>- kushton më shumë se pipat e zakonshme | - larje pas çdo përdorimi<br>- investime të vogla<br>- zëvendësimi pas 100 përdorimeve |
| Rossman&Lala , JUMBO, etj. | Rossman&Lala,JUMBO, Spar, etj. |



## *NJË VEPRIM I VOGËL PËR JU, NJË NDRYSHIM I MADH PËR NATYRËN.*

*Në vend të tyre, ofro pipat e bukura, të ripërdorshme, ekologjike dhe stil!*
*Inkurajoni klientët tuaj që të mos përdorin pipa nëse nuk kanë një gjendje shëndetësore ose paaftësi që i bën pipat të domosdoshëm për ata.*

| HAPI 3.24 QELQ | HAPI 6.21 LETRE |
|---|---|
| *25-55LEK (varet nga parametrat fizik)* | *5-15 LEK* |
| *- Afatgjatë i ripërdorshëm<br>- origjinal<br>- modern<br>- investim fillestar që shtrihet në kohë* | *- E thjeshtë për t'u përdorur<br>- e përballueshme* |
| *- larje pas çdo përdorimi<br>- investime të vogla<br>- mund të thyhet* | *- Për njëpërdorim<br>- mund të shformohet<br>- e shtrenjtë për një kohë të gjatë* |
| *JUMBO, etj.* | *Rossman&Lala, JUMBO,Spar, etj.* |

HAPI
10

## PËRZIERËSIT PLASTIK TË KAFESË



### *KUSH KËNAQET TA PËRZIEJË KAFENË ME... PLASTIKË?*

*Jo vetëm që nuk duket bukur, por edhe përfundon lehtësisht në natyrë duke ndotur mjedisin.*
*Gjithashtu kur një lugë plastike zhytet në kafe të nxehtë, ajo mund të lëshojë përbërës kimikë të dëmshëm që ndikojnë në cilësinë e pijes dhe në shëndetin tonë .*

HAPI
0

## LUGË DRURI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *0.5-1 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- Ekonomike*<br>*- të kompostueshme* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Për njëpërdorim për ekspres*<br>*- i shtrenjtë për një kohë të gjatë* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Kompanitë e kafesë,*<br>*Rossmann&Lala,JUMBO, BigMarket, etj.* |

## KOHA PËR NJË ALTERNATIVË MË TË QËNDRUESHME!

*Zgjidh lugët prej druri ose materiale të ripërdorshme, më të shëndetshme për ty dhe më të sigurta për natyrën.*

HAPI 7.38

### LUGË INOKSI

| | |
|---|---|
| CMIMI | 40-90 LEK |
| AVANTAZHET | - E ripërdorshme<br>- ndjenjë e stilit të lartë<br>- afatgjatë me kosto efektive<br>- më e lehtë për tu përzier |
| DISAVANTAZHET | - Larja e nevojshme<br>- investime të vogla<br>- mund të humbasin |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | Kompaminitë e kafesë, JUMBO, BigMarket, etj. |

HAPI
10



# GOTA DHE FILXHANË PLASTIK

*GOTAT PLASTIKE DHE FILXHANËT NJËPËRDORIMËSH?*
*Jashtë mode!*

HAPI
3.15

## GOTË QELQI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *40-90LEK* |
| **AVANTAZHET** | - E ripërdorshme ndjenja e stilit të lartë<br>- me kosto efektive afatgjatë<br>- mund të personalizohen |
| **DISAVANTAZHET** | *- larja e nevojshme<br>- investim i vogël<br>- mund të thyhet<br>(nëse është shumë e hollë)* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *JUMBO, Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj.* |

## *KA ARDHUR KOHA TË ZGJEDHIM MË MIRË!*

*Jo vetëm që janë të pakëndshëm për t'u përdorur, por edhe ndër ndotësit më të zakonshëm në natyrë.*

HAPI 3.15

## GOTË MELAMINE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *40-100LEK* |
| **AVANTAZHET** | - I ripërdorshëm<br>- i lehtë për t'u përdorur<br>- lahet dhe ruhet<br>- nuk prishet<br>- me kosto-efektive për një kohë të gjatë |
| **DISAVANTAZHET** | *- Jo për përdorim në mikrovalë*<br>*- jo i riciklueshëm në Shqipëri*<br>*- procesi i prodhimit joekologjik mund të humbas* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Dyqanet Shumice/Pakice, BigMarket, Rossman&Lala, JUMBO, etj.* |

*PROVONI KËTO ALTERNATIVA TË QËNDRUESHME, ELEGANTE DHE MIQËSORE ME MJEDISIN, TË CILAVE NUK DO T'U REZISTONI.*

**P1P** – *plastika një përdorimshme po mbush lumenjtë, plazhet dhe pyjet tona.*

HAPI
3.69

## GOTË NGA PLASTIKË E FORTË

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *60-200 lek* |
| **AVANTAZHET** | - I ripërdorshëm<br>- i lehtë për t'u përdorur<br>- lahet dhe ruhet<br>- me kosto efektive për një kohë të gjatë |
| **DISAVANTAZHET** | *- Nuk mund të riciklohen në Shqipëri<br>- procesi i prodhimit joekologjik<br>- mund të thyhet* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *JUMBO,BigMarket etj.* |

HAPI
7.38



## SHISHE PLASTIKE UJI

### *NJË VEPRIM I THJESHTË: OFRONI UJË NGA APARATI JUAJ PËR KLIENTËT.*

*Elegante, e qëndrueshme dhe e miqësore me mjedisin.*

HAPI
1.85

## APARAT UJI ME ENË 19-20L

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *450-650L*<br>*(për enë, aparati ofrohet falas për përdorim të vazhdueshëm)* |
| **AVANTAZHET** | *- E kompostueshme* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Më pak mbeturina të gjeneruara*<br>*- cilësi e mirë e ujit në dispozicion në çdo kohë*<br>*- kthimi i enëve 19-20 L tek prodhuesi per sterilizim dhe riciklim* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Donald Shpk, Eko Leter / Eko Leter 09, Orto Paper etj.* |

*ÇDO GOTË E PËRDORUR NGA APARATI JUAJ ËSHTË NJË HAP DREJT NJË PLANETI MË TË PASTËR.*

*Thjeshtë, por me ndikim të madh!*

**HAPI** 4.73-6.3

## UJE NE SHISHE QELQI (0.125-0.75 l)

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *50-150 Leke*<br>*(në varësi te furnitorit)* |
| **AVANTAZHET** | *- Komforte*<br>*- uji qëndron më i pastër*<br>*- shishja mund të ripërdoret ose riciklohet nga kompanitë përkatëse* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Mund të thyhet*<br>*- kompanitë mund të mos e marrin përsëri për të ricikluar* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Kompani të ujit si Lajthiza, Qafështama, furnizues lokal shumice etj.* |

HAPI
7.38



## SHISHE PLASTIKE LËNGJESH

*SHQIPËRIA PO SHPËRTHEN ME FRUTA!*

*Nga jugu deri në veri, tregu shqiptar ofron një larmishmëri të pabesueshme frutash, madje edhe jashtë sezonit falë prodhuesve të zonave të ndryshme dhe importit.*

HAPI
3.69

## APARAT PËR LËNGJE

| | |
|---|---|
| CMIMI | 100.000-200.000LEK |
| AVANTAZHET | - Cilësi dhe freski më të mirë të lëngjeve të servirura |
| DISAVANTAZHET | - Varësia nga një furnitor<br>- procedura e importit<br>- investim i lartë fillestar |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | Distributor të ndryshëm të kompanive të lëngjeve të frutave |

*ZGJIDH MË TË MIRËN QË OFRON SHQIPËRIA, PËR SHIJEN, SHËNDETIN DHE PLANETIN!*

*Jo vetëm që është më e shijshme se çdo lëng industrial, por edhe gjeneron më pak paketime dhe mbështet ekonominë vendase. Freski nga natyra, përgjegjësi ndaj mjedisit.*

HAPI 0

## LENGJE FRUTASH TË SHTRYDHURA

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | Varet nga frutat dhe stina |
| **AVANTAZHET** | - E shëndetshme dhe  e shijshme<br>- zero mbetje |
| **DISAVANTAZHET** | - Asnjë |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | Furnizim nëpërmjet tregtarëve të fruta/perimeve më të afërt |

HAPI
4.73-6.3

## SHURUPET NATYRALE NË QELQ

| | |
|---|---|
| CMIMI | 350-800LEK |
| AVANTAZHET | - zero mbetje nëse gotat e qelqit ripërdoren |
| DISAVANTAZHET | - Asnjë |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | Lajthiza Bio, AgnaGroup etj |

HAPI 7.38




## PORCIONE INDIVIDUALE CAJI

*A E DINI QË SHUMË PAKETIME DHE MBËSHTJELLËS ÇAJI PËRMBAJNË PLASTIKË?*

*Kur bustina plastike ekspozohet në ujë të nxehtë, mund të lëshojë mikropjesëza të rrezikshme. Një praktikë krejtësisht e pakuptimtë, që dëmton si shëndetin tuaj, ashtu edhe natyrën.*

HAPI 0

## ÇAJ BIO ME KUTI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | ***250-450 LEK*** <br> ***(Varet nga lloji, sasia dhe cilësia)*** |
| **AVANTAZHET** | ***- Çaj me cilësi më të lartë*** <br> ***- ndjenjë e stilit të lartë*** <br> ***- zero mbetje*** |
| **DISAVANTAZHET** | ***- Procedura e shërbimit më gjatë*** <br> ***- kërkon larjen e kulluesit*** |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | ***Furnitoret e kafesë, Pikat e shumicës etj.*** |

*ZGJIDHNI ÇAJ BIO DHE PËRDORNI FILTRA TË RIPËRDORSHËM.*

*Më i pastër, më i shëndetshëm, më i qëndrueshëm.*

HAPI
0

## ÇAJ ME 100% MBËSHTJELLJE LETRE

| | |
|---|---|
| CMIMI | *Nuk gjendet lehtë* |
| AVANTAZHET | *- I kompostueshëm* |
| DISAVANTAZHET | *- Paketim sekondar plastik per qeset e çajit*<br>*- gjenerohen më shumë mbeturina* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | |

HAPI
7.38

## QESE ME PORCIONE PËR KAKAO/ÇOKOLLATË/SALEP




*Çdo paketim plastik i vogël që përdorim individualisht mund të zgjasë deri në 500 vite në natyrë. Duke përdorur porcione të mëdha reduktojmë mbetjet plastike.*

HAPI
6.21

## PAKETIM I MADH ME LUGË
*(për kakao/salep/etj.)*

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *20–38 LEK/ njësi* |
| **AVANTAZHET** | *- Më lirë për njësi në afat të gjatë. Ul koston totale të paketimit dhe materialeve.*<br>*- Përfitim mjedisor falë reduktimit të ndjeshëm të mbetjeve krahasuar me racionet individuale.*<br>*- Menaxhim më i lehtë i stokut për përdorim.* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Kërkon protokolle shtesë higjiene për përdorim.*<br>*- Kërkon investim në lugë të ripërdorshme dhe mbyllje të mirë.*<br>*- Mund të ketë lëvizje në madhësi të porcioneve nëse nuk menaxhohet me kujdes.* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *spar, big market, conad, alb kuzhina, xhangolli, rossman lala, bio ju* |

## *B. USHQIMET*

**B.1** *Paketimet plastike për ushqimet*
**B.2** *Qeset plastike*
**B.3** *Paketimi për akulloret*
**B.4** *Lugë për akullore*
**B.5** *Pjata plastike*
**B.6** *Takëme plastike*
**B.7** *Shkopinj plasatik për antipasta*
**B.8** *Porcione individuale në mbështjellës plastik njëpërdorimësh (Vaj, uthull, mjaltë, krem çokollatë, gjalpë, drithëra, kos, ëmbëlsira, snacks etj.)*
**B.9** *Mbulese tavoline prej letre me një shtresë të hollë plastike*

# USHQIME



HAPI
10

# PAKETIMET PLASTIKE PËR USHQIMET



*PAKETIMI I USHQIMIT ËSHTË NJË PROBLEM I MADH!*

*Së pari, jepeni vetëm kur klienti e kërkon me të vërtetë. Këtu janë disa alternativa të qëndrueshme që bëjnë diferencën.*

HAPI
7.02

## PAKETIM KARTONI

| | |
|---|---|
| CMIMI | 10-50 LEK (sipas sasisë dhe përmasave) |
| AVANTAZHET | - Material i fortë<br>- i kompostueshëm<br>- i thjeshtë për t'u shërbyer në plazh<br>- alternative për marrje me vete |
| DISAVANTAZHET | - jo i riciklueshëm<br>- një përdorimshe<br>- ndikim mjedisor nga bojrat (Kur ka logo) |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | Konfeti.al, Boxes Albania, Print Spot Albania,etj. |

*ZGJEDHJE TË MENÇURA PËR NJË PLANET MË TË PASTËR!*

HAPI 7.02

## KUTI KARTONI PËR USHQIME TË NDRYSHME

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | 10-40LEK (sipas sasisë dhe përmasave) |
| **AVANTAZHET** | - Material i fortë<br>- I kompostueshëm<br>- I thjeshtë për t'u shërbyer në plazh<br>- alternative për marrje me vete |
| **DISAVANTAZHET** | - jo i riciklueshëm<br>- një përdorimshe<br>- ndikim mjedisor nga bojrat (kur ka logo) |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | Konfeti.al, Boxes Albania, Print Spot Albania,etj. |

HAPI
3.51

## PAKETIM ALUMINI ME KAPAK

| | |
|---|---|
| CMIMI | 15-40 LEK (sipas sasise dhe permasave) |
| AVANTAZHET | - E mirë për ushqime të nxehta |
| DISAVANTAZHET | - Jo i fortë<br>- I lehtë për t'u palosur<br>- një përdorimshe |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | LBL Pack, Furnitore Nderkombetar, Versupack etj. |

**HAPI**
10

## QESET PLASTIKE




### *LAJM I MIRË: QESET PLASTIKE NUK JANË MË NË MODË!*

*Nuk ka nevojë t'i ofroni automatikisht. Pyesni me mirësjellje klientët nëse kanë çantën e tyre apo mund të mbajnë porosinë në dorë. Mos nguroni ta bëni këtë, është një hap i vogël, por me ndikim të madh për mjedisin!*

**HAPI**
4.66

## ÇANTA LETRE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *10-50 LEK (sipas sasise dhe permasave)* |
| **AVANTAZHET** | *- E kompostueshme* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Ndikim në mjedis*<br>*- një përdorimshe*<br>*- mund të griset* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Donald Shpk, Eko Leter / Eko Leter 09, Orto Paper etj.* |

## *EDHE MË MIRË: BËNI NJË REKLAMË!*

*Krijoni çanta të qëndrueshme eko me brandin tuaj, për ata që kanë vërtet nevojë për një. Një mënyrë funksionale, e qëndrueshme dhe një mundësi fantastike për të promovuar biznesin tuaj!*

HAPI 2.63

## ÇANTA TORBE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *200-600LEK*<br>*(sipas sasise, permasave dhe stampimeve)* |
| **AVANTAZHET** | *- Mund të shërbejë si material promovues*<br>*- i ripërdorshëm* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Njëpërdorimshme* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *JUMBO, Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket, Rossmann&Lala etj.* |

HAPI
7.38

## PAKETIMI PËR AKULLORE



*NËSE NUK DO TA HEDHËSH... HAJE!*

*Zgjidh akullore të freskëta me kaush të ngrënshme, të shijshme dhe pa mbeturina!*

HAPI
7.02

## GOTA AKULLORE PREJ KARTONI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *6-15 LEK*<br>*(përmasat, sasia dhe personalizimet)* |
| **AVANTAZHET** | *- E fortë*<br>*- mund të kompostohet*<br>*(nëse nuk ka shtresë plastike)* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Njëpërdorim*<br>*- jo të riciklueshëm*<br>*- mbart ushqim* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *Cupking Albania, Previsash shpk, Mari Sh.P.K, etj.* |

*DHE NËSE NUK ËSHTË E MUNDUR, ZGJIDH NJË ENË KARTONI QË TRETET MË LEHTË NË NATYRË.*

*Veprime të vogla që sjellin ndryshim të madh për mjedisin.*
*Shijo ëmbëlsinë, jo mbetjet!*

HAPI
0

## KORNET AKULLORJE TË NGRËNSHME

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *3-15 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *Zero mbetje* |
| **DISAVANTAZHET** | *Preferenca e klientëve* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *AMG Food (importues)* |

HAPI 7.38



## LUGË PËR AKULLORE

*LUGA PREJ DRURI ËSHTË ENDE NJË ZGJEDHJE E MIRË!*

*Edhe nëse nuk hidhet në vendin e duhur, ajo përsëri tretet natyrshëm në mjedis, pa dëmtuar natyrën si plastika.*

HAPI 6.48

## LUGË DRURI PËR NJËPËRDORIM

| | |
|---|---|
| CMIMI | *5-10 LEK* |
| AVANTAZHET | *E KOMPOSTUESHME* |
| DISAVANTAZHET | *NJË PËRDORIM* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *JUMBO, SPAR, BIGMARKET ETJ.* |

HAPI
7.38

## PORCIONE INDIVIDUALE NË MBËSHTJELLËS PLASTIK NJËPËRDORIMËSH



*(vaj, uthull, mjaltë, krem çokollatë, gjalpë, drithëra, kos, ëmbëlsira, snacks etj.)*

*HULUMTIMET TREGOJNË SE KA NJË SHQETËSIM NË RRITJE TË PUBLIKUT PËR AMBALAZHET PLASTIKE.*

*Klientët do të vlerësojnë përpjekjet tuaja për të reduktuar mbeturinat e panevojshme, si p.sh. paketimet individuale.*

HAPI
3.69-5.54

## KONTEJNERË TË RIMBUSHSHËM OSE PJESË INDIVIDUALE TË MBUSHURA NGA KONTEJNERË TË MESËM

*(deri në 1L/1kg) ose më të mëdhenj*

| | |
|---|---|
| CMIMI | *varësisht nga tipi i produktit* |
| AVANTAZHET | *më pak mbeturina të gjeneruara, komforte* |
| DISAVANTAZHET | *kohë më të gjatë shërbimi* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *spar, big market, conad, alb kuzhina, xhangolli, rossman lala, bio ju* |

HAPI
10

## PJATA PLASTIKE



*KUSH NUK KA PËRJETUAR NDJESINË/VËSHTIRËSINË E NJË PJATE PLASTIKE TË TEJMBUSHUR? NUK ËSHTË KOMODE!*

HAPI
3.51

## PJATA QERAMIKE

| | |
|---|---|
| CMIMI | 80-390 LEK |
| AVANTAZHET | - Ndjenjë klasi<br>- Rehati në mbajtjen e ushqimit |
| DISAVANTAZHET | - Mund të thyhet<br>- investim i vogël |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | JUMBO, Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj. |

HAPI 7.02

## PJATA LETRE

| | |
|---|---|
| CMIMI | 200-500 LEK |
| AVANTAZHET | - I lehtë për t'u përdorur<br>- larë dhe ruajtur |
| DISAVANTAZHET | - Rrezik i ulët për humbje<br>- jo për përdorim në mikrovalë<br>- jo i riciklueshëm<br>- procesi i prodhimit nuk është ekologjikë |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | JUMBO,Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj. |

HAPI 3.69

## PJATA MELAMINE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | 200-500 LEK |
| **AVANTAZHET** | - I lehtë për t'u përdorur<br>- larë dhe ruajtur |
| **DISAVANTAZHET** | - Rrezik i ulët për humbje<br>- jo për përdorim në mikrovalë<br>- jo i riciklueshëm<br>- procesi i prodhimit nuk është ekologjikë |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | JUMBO,Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj. |

HAPI
10

# TAKEMET PLASTIKE



## *KA ARDHUR SËRISH KOHA E RIPËRDORIMIT!*

*Rekomandojmë një zëvendësim për takëme plastikë e një përdorimshme me takëme prej inoksi.*

HAPI
3.24

## TAKËME NGA INOKSI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *64-72 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- E ripërdorushme*<br>*- ndjenja e stilit të lartë*<br>*- të qëndrueshme* |
| **DISAVANTAZHET** | *- larja e nevojshme*<br>*- investime të vogla*<br>*- mund të humbin* |
| | |

*PO, ËSHTË SHUMË E THJESHTË TË JESH I QËNDRUESHËM!*

*Kur klientët marrin ushqimin me vete, nuk ka nevojë për paketim shtesë. Kjo është një zgjidhje më e pastër, më ekonomike dhe më e përgjegjshme ndaj mjedisit*

HAPI 6.48

## TAKËME PËR NJËPËRDORIM NGA DRURI

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *80-100 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- E kompostueshme* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Njëpërdorimshme* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *JUMBO, Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj.* |

HAPI
7.38

## SHKOPINJ PLASATIK PËR ANTIPASTA



*NËSE ME TË VËRTETË KENI NEVOJË PËR NJË TË TILLË, ZGJIDHNI ATË PREJ DRURI, JO PLASTIKË.*

Edhe më mirë, përdorni pirunjtë metalike të disponueshëm në bufe.

Zgjidhje të thjeshta, ndikim i madh për mjedisin!

HAPI
6.48

## SHKOPINJ DRURI PËR ANTIPASTA

| | |
|---|---|
| CMIMI | *0.4-1 LEK* |
| AVANTAZHET | *- E kompostueshme* |
| DISAVANTAZHET | *- E disponueshme*<br>*- e mbështjellë me letër (e variushme)* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *JUMBO, Dyqane Shumice/Pakice, BigMarket etj.* |

HAPI
10

# MBULESE TAVOLINE PREJ LETRE ME NJË SHTRESË TË HOLLË PLASTIKE

*PËRDORIMI I MBULESAVE TË TAVOLINËS ME SHTRESË PLASTIKE NUK ËSHTË I QËNDRUESHËM PËR MJEDISIN.*

HAPI
2.63

## MBULESE TAVOLINE PREJ COPE

| | |
|---|---|
| CMIMI | *700–2,000 LEK* |
| AVANTAZHET | *- Blihet një herë*<br>*- kursim afatgjatë*<br>*- e ripërdorshme*<br>*- nuk prodhon mbetje plastike apo letre.* |
| DISAVANTAZHET | *- Kosto fillestare dhe kërkon larje.* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *JYSK, Casa Italia, Megatek, tregjet lokale të aksesorëve për shtëpi.* |

*ZGJIDHNI ALTERNATIVA MIQËSORE:*
*mbulesa cope apo materiale biodegradueshme. Kështu reduktojmë mbeturinat plastike dhe mbrojmë natyrën*

**HAPI**
0

## PA MBULESË TAVOLINE FARE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *0 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- Kosto zero*<br>*- Mbeturina zero* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Mund të mos jetë i përshtatshëm për të gjitha rastet.* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | |

## C. SIGURIA DHE HIGJENA

**C.1** *Produkte plastike tualeti*
**C.2** *Shishe plastike xhel dezinfektues*
**C.3** *Doreza plastike për një përdorim*
**C.4** *Shkopinj plastik me pambuk*
**C.5** *Furça dhëmbësh + pastë dhëmbësh njëpërdorimshe*
**C.6** *Kapuc dushi*
**C.7** *Fije dentare me kunja plastike*
**C.8** *Shapka njëpërdorimshe*

# SIGURIA DHE HIGJIENA



HAPI
7.38



## PRODUKTE PLASTIKE TUALETI

*SHUMË MINI-PAKETIME PLASTIKE NË HOTELE PËR PRODUKTE HIGJENIKE MUND TË SHTOJNË TONËRA MBETJE PLASTIKE ÇDO VIT.*

HAPI
3.69

### PAJISJE TUALETI NË KONTEJNERË TË RIPËRDORSHËM,

TË RIMBUSHUR NGA KONTEJNERË TË MËDHENJ

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | 100 Lek / Litri |
| **AVANTAZHET** | - Kosto më e ulët për përdorim krahasuar me shishet individuale.<br><br>- Redukton ndjeshëm plastikën dhe mbetjet e paketimit.<br><br>- Thjeshton mbushjen dhe menaxhimin e stokut. |
| **DISAVANTAZHET** | - Kërkon investim fillestar për dispenzerët.<br><br>- Duhet pastrim dhe mbushje e rregullt për higjienë.<br><br>- Në disa ambiente duhen masa kundër vjedhjes ose të mbyllur me kyç |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | Megatek, JYSK, furnitorë B2B për hotele, DM, EcoHome |

*Përdorimi i kontenjerëve të ripërdorshëm ose paketimeve të mëdha është një alternativë më e qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin.*

HAPI 6.21

## SAPUNE, SHAMPO PA AMBALAZHE PLASTIKE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | 100 LEK + |
| **AVANTAZHET** | - më pak mbetje të krijuara<br>- ndikim mjedisor |
| **DISAVANTAZHET** | - Asnjë |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | GURU aroma, SPAR, BIG Market, CONAD, ALB Kuzhina, Xhangolli, Rossman Lala, |

HAPI
0

## POLITIKA BYO
*(SILLNI PRODUKTET TUAJA)*

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | 0 LEK |
| **AVANTAZHET** | - pa kosto<br>- mundësi për të edukuar klientët në P1P |
| **DISAVANTAZHET** | - duhet të bind klientët |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | |

HAPI 7.38

## SHISHE PLASTIKE XHEL DEZINFEKTUES



HAPI 3.69

## XHEL DEZINFEKTUES NË KONTEJNERË TË MËDHENJ TË DISPONUESHËM

HAPI 0

## PROTOKOLLI I LARJES SË DUARVE

| | | |
|---|---|---|
| CMIMI | *400 LEK / 500 ml* | *0 LEK* |
| AVANTAZHET | *- më pak mbetje të krijuara* | *- pa kosto, pa mbeturina të krijuara* |
| DISAVANTAZHET | *- nje perdorimshe* | *- duhet të bind klientët* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *GURU aroma* | |

HAPI
8.1

# DOREZA PLASTIKE PËR NJË PËRDORIM



HAPI
4.05

## DOREZA GOME TË RIPËRDORSHME

HAPI
0

## PROTOKOLLI I LARJES SË DUARVE

| | | |
|---|---|---|
| CMIMI | *200-1000 LEK* | *0 LEK* |
| AVANTAZHET | *- të përballueshme*<br>*- më pak mbetjetë gjeneruara* | *- pa kosto*<br>*- pa mbeturina të krijuara* |
| DISAVANTAZHET | *- nje perdorimshe* | *- duhet të bind klientët* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *Rossman Lala, BIOJu* | |

HAPI
10



## SHKOPINJ PLASTIKE ME PAMBUK

*RRETH 20 MILIARDË SHKOPINJ PAMBUKU ME PLASTIKË PËRDOREN ÇDO VIT GLOBALISHT, DHE SHUMICA E TYRE PËRFUNDOJNË NË KOSH.*

HAPI
6.48

## SHKOPA PAMBUKU TË BIODEGRADUESHME TË DISPONUESHME

| | |
|---|---|
| CMIMI | *200 LEK + / 200 copë* |
| AVANTAZHET | *- e kompostueshme (pra për t'u kompostuar!)* |
| DISAVANTAZHET | *- Më pak rezistent si material*<br>*- Ndjeshmëri ndaj lagështisë*<br>*- Mund të kenë çmim pak më të lartë* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *SPAR, BIG Market, CONAD, ALB Kuzhina, Xhangolli, Rossman Lala, Bio Ju* |

*Në destinacionet turistike si Shqipëria, përdorimi i shkopave të biodegradueshëm (letër ose bambu) mund të reduktojë ndjeshëm ndotjen plastike dhe të mbrojë ekosistemet lokale.*

HAPI 7.38

## SHKOPAT E PAMBUKUT TË DISPONUESHËM JANË ELIMINUAR

| | |
|---|---|
| CMIMI | *0 LEK* |
| AVANTAZHET | *- pa kosto*<br>*- pa mbeturina të krijuara* |
| DISAVANTAZHET | *- duhet të bind /shpjegojë klientët* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | |

**HAPI**
7.38




# FURÇA DHËMBËSH + PASTË DHËMBËSH NJEPERDORIMSHE

**HAPI**
0

## BYO – FURÇA DHE PASTA PERSONALE

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *0 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- Kosto zero, asnjë inventar për t'u menaxhuar.*<br>*- Zero mbetje nga paketimi.*<br>*- Pozicionim i qartë ekologjik për hotele ekonomike/eko.* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Jo i përshtatshëm për kategori mysafirësh mesatare/të lartë me pritshmëri për higjienë.*<br>*- Rrezik pakënaqësie nëse mysafirët i harrojnë.*<br>*- Recepsioni duhet të ketë gjithsesi një plan rezervë.* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | |

*ÇDO MINI-FURÇË DHE PAKETIM PLASTIKE QË PËRDORIM LË GJURMË PËR QINDRA VITE.*

*Zgjidh alternativa të mëdha ose biodegradueshme mbro mjedisin dhe Shqipërinë e bukur!*

HAPI
3.69

## BLERJA E FURÇAVE TË RIPËRDORSHME

140–350 LEK

- Kosto e ulët për njësi

- Plotëson pritshmëritë e mysafirëve kur harrojnë artikujt personalë.

- Ripërdorimi krijon më pak mbetje se furçat njëpërdorimshme.

- Mund të shiten në recepsion për fitim të vogël.

- Shumicën e rasteve përdoren nga një mysafir (për higjienë) = kosto e përsëritur nëse ofrohen falas.

- Kërkon menaxhim stoku dhe hapësirë magazinimi.

- Cilësia ndryshon sipas furnitorit; rrezik prishjeje ose kthimi.

- Disa mbetje nga paketimi mbeten.

Rossmann & Lala, DM, Big Market

HAPI
3.69

## MBAJTËSE PASTE DHËMBËSH E RIMBUSHSHME

220–800 LEK

- Redukton ndjeshëm mbetjet e paketimit krahasuar me minipaketimet.

- Kosto më e ulët për përdorim kur merren me shumicë.

- Mund t'i shitet mysafirëve (fitim i vogël).

- Përputhet me standardet e qëndrueshme/minimaliste; mundësi brandimi.

- Nevojiten procedura higjiene për rimbushje.

- Investim fillestar dhe rrezik humbjeje nëse mysafirët i marrin pa I blerë.

- Kërkon logjistikë rimbushjeje (furnizim me shumicë, etiketim, kohë stafi).

- Jo ideale për hotele që preferojnë produkte të mbyllura njëpërdorimshme.

Green Living Tirana, AliExpress/Online.

HAPI 7.38

## KAPUC DUSHI



HAPI 4.05

### KAPUC DUSHI PREJ SILIKONI E RIPËRDORSHME

| | |
|---|---|
| CMIMI | *50–450 LEK* |
| AVANTAZHET | *- Ripërdorim i shumëfishtë, kursim afatgjatë.*<br>*- Më e qëndrueshme dhe më komode se kapucët plastike.*<br>*- Redukton ndjeshëm mbetjet plastike njëpërdorimshme.*<br>*- E përshtatshme për imazhin eko të hotelit.* |
| DISAVANTAZHET | *- Investim fillestar.*<br>*- Duhet larë e tharë mes përdorimeve.*<br>*- Mysafirët mund të mos i kthejnë ose t’i marrin rastësisht.* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *Rossmman & Lala, AliExpress, BigMarket* |

HAPI 4.05

## KAPUC NOTI

*200–2000 LEK*

*- Shumë e qëndrueshme, për shumë përdorime.*

*- Siguron mbyllje më të fortë, e dobishme për mysafirët që notojnë ose bëjnë shpesh dush.*

*- Mund të brandohet dhe të shitet ose ofrohet në dhoma premium.*

*- Tërheq mysafirë aktivë ose të fokusuar në fitnes.*

*- Më pak komode për përdorim të zakonshëm në dush.*

*- Mund të duket e panevojshme për disa mysafirë.*

*- Kërkon protokolle higjiene për ripërdorim.*

*Intersport, Decathlon online, farmaci, DM*

HAPI
0

## PA KAPELË DUSHI

*0 LEK*

*- Zero kosto dhe zero mbetje.*

*- Thjeshton logjistikën dhe menaxhimin e stokut.*

*- Tregon përkushtim ndaj reduktimit të ndikimit mjedisor.*

*- Nxit mysafirët të sjellin kapucët e tyre (BYO).*

*- Mund të zhgënjejë mysafirët që presin kapelë si pjesë e standardit.*

*- Jo i përshtatshëm për të gjitha tipologjitë e hoteleve, sidomos ato full-service.*

*- Mund të sjellë komente negative nëse nuk komunikohet qartë.*

HAPI
7.38

## FIJE DENTARE ME KUNJA PLASTIKE



HAPI
6.48

## FIJE DENTARE KLASIKE E PAKETUAR

| | |
|---|---|
| **CMIMI** | *110–500 LEK* |
| **AVANTAZHET** | *- Më lirë dhe më kompakte se fijet me kunja.*<br>*- Redukton plastikën, sidomos nëse paketohet me karton ose materiale eko.*<br>*- Më e lehtë për t'u ruajtur dhe shpërndarë me shumicë në hotele/hostele.* |
| **DISAVANTAZHET** | *- Më pak e përshtatshme për përdorues të moshuar ose fëmijë.*<br>*- Kërkon përdorim më të drejtpërdrejtë nga mysafirët perceptohet më pak higjienike në ambiente të përbashkëta.* |
| **DYQANET KU MUND TE BLIHEN** | *DM, Rossmann, Farmatech, Green Living* |

HAPI
8.1

# SHAPKA NJËPËRDORIMSHE



HAPI
0

## BYO

| | |
|---|---|
| CMIMI | *0 LEK* |
| AVANTAZHET | *Zero kosto* |
| DISAVANTAZHET | *- Mungesë shërbimi*<br>*- pakënaqësi nga klienti* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | |

*Një palë shapka plastike njëpërdorimshe mund të zgjasë më shumë se një vizitë në hotel... në natyrë!*

HAPI
6.21

## PANTOFLA TË RIPËRDORSHME

| | |
|---|---|
| CMIMI | *150–1000 LEK* |
| AVANTAZHET | *- Efikasitet afatgjatë në kosto falë ripërdorimit.<br>- Redukton ndjeshëm mbetjet nga pantoflat njëpërdorimshme.<br>- Përmirëson imazhin profesional dhe eko të hotelit.* |
| DISAVANTAZHET | *- Kërkon protokoll pastrimi për higjienë.<br>- Rrezik humbjeje ose dëmtimi nëse nuk menaxhohet.<br>- Investim fillestar më i lartë se opsionet njëpërdorimshme.* |
| DYQANET KU MUND TE BLIHEN | *Çdo treg, Metro Albania, furnitorë për hotele, Alibaba* |

RIVER CLEAN

www.milieukontakt.org